



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISE  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2657 /2 Prot.

Patos, më 30/11/2022

**PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE 23 NËNTOR 2022**

**Vendi:** Salla e Këshillit Bashkiak.

**Ora:** 13:00

**Tema e Konsultimit:** “Rikualifikimi urban”, blloku i lagjes “Naftëtari” pranë shkollës 9-vjeçare “Muhamet Shehu”, Patos dhe “Rikonstruksioni i shkollës Muhamet Shehu dhe ndërtimi i palestrës”.

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”nëni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjet nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin Publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52, Rregullores së KëshillitBashkiak “Për Konsultimin Publik”si edhe kërkesës së Bashkisë Patos me nr.2657 prot datë 24.10.2022.

**Pjesëmarrës:** Kryetarja e Bashkisë znj.RajmondaBalilaj, Sekretari i Këshillit Bashkiak Z.Balil Balilaj, Drejtori i Shërbimeve publike Z.Arben Maroku, Drejtoresha Rajonale e Arsimit Fier znj.Flutura Mecaj, Drejttore e Zyrws Arsimire Vendore patos znj. Zamira Velçani, Koordinatorja e Konsultimit Publik znj.Suzana Hysenaj, Drejtori Ekzekutiv/INFOCIP, Z.GertiShella, Rreth 75 pjesëmarrës (mësues, nxënës, banorë)

**Takimin e hapi Sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Balil Balilaj,** i cili falenderoi të gjithë për pjesëmarrjen. Pjesëmarrja juaj është tregues që ne komunitetin e qytetit e bëjmë pjesë të funksionit të bashkisë. Bazuar në Ligjin për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik” ne ju informojmë ju që të ushtroni të drejtën tuaj në qeverisjen vendore, në hartimin e politikave

---

**Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 1

përpara se ato të bëhen projekt-vendime. Pa u zgjatur, për dëgjesën e sotme specifisht do të flase ekzekutivi, Kryetarja e Bashkisë dhe Inxhineri përkatës.

 <p>Bashkia Patos, Rikualifikimi i bllokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu" - pjesa 1</p>	<p><b>Minuta: 00:00-00:50 Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwiYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwiYAVY</a></p> <p><b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagje-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagje-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/</a></p>
--	---

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balili:** Përshëndetje të gjithëve, faleminderit që jeni sot këtu në këtë dëgjesë publike. Ndihem shumë e lumtur për zhvillimin e kësaj dëgjese publike, sepse ka të bëjë me një zhvillim infrastrukturor, qoftë për ata përfituesit që janë në fushën e arsimit, qoftë edhe përfituesit që janë banorët e bllokut që do të investohet tani së shpejti në lagjen “Naftëtari”. Nuk ka ndodhur ndonjëherë, ose është rasti i dytë mund të themi që investohet njëkohësisht edhe në bllok edhe në rikonstrukcionin total të shkollës. E para ka qënë ajo me “Zhani Cikon” dhe bllokun e “29 Marsit” dhe sot jemi në një investim tjetër të rëndësishëm të rikualifikimit të bllokut dhe rikonstrukzionit të shkollës. Une falenderoj të gjithë banorët që kanë ardhur nga blloku i lagjes “Naftëtari” dhe komunitetin e mësuesve dhe nxënësve. Bashkia Patos e ka patur gjithmonë në vëmendje sesi mund të forcojë demokracinë lokale nëpërmjet transparencës dhe nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimarrëse. Procese vendimarrëse së pari ne kemi mbledhjet e këshillit që transmetohen online por edhe me pjesëmarrjen e qytetarëve. Së dyti, kemi shumë vite që ne aplikojmë në prezantimin e projekteve zhvillimin e një zone së bashku me qytetarët. Në këtë kuptim, ashtu sikurse e përmendi edhe sekretari i këshillit ne duam që qytetin ta zhvillojmë së bashku, gjithësecili të japë mendimin e vet, sigurisht që nëse do të kishte banorë të tjera nga lagje të tjera, dhe për këtë jam e sigurt, do të kërkonin zhvillimin e bllokut apo lagjeve të tyre, por ne planifikojmë brenda një viti buxhetor, me të ardhurat që sigurojmë nga buxheti i brëndshëm dhe nga të gjitha përpjekjet që bën bashkia për të siguruar burime të tjera financimi për të përballuar më shumë nga ato që janë të parashikuara në buxhet. Kështu duke falenderuar edhe Z.Gerti Shellën, Drejtor Ekzekutiv i

**Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 2

INFOCIP (Qëndra për Cështjet e Informimit Publik) i kontraktuar nga projekti që ndjek rritjen e demokracisë lokale në pushtetet vendore sic është STAR 3. Sot ai është për të monitoruar dhe për të na përvendetur edhe për këtë dëgjesë publike. Faleminderit Z.Gerti që jeni këtu, faleminderit që na suportoni dhe në këtë fushë, në rritjen e demokracisë vendore, ju jam mirënjojës për këtë. Gjithashtu, Drejtori i Shërbimeve publike Z.Arben, do të bëjë një prezantim të shkurtër të projektve të cilët përfitues jeni ju e përtej jush shumë qytetarë të tjerë. Dy tregues të përgjithshëm do të thoja, blloku i lagjes “Naftëtari” që do të investohet me buxhetin e bashkisë në këtë vit buxhetor, zhvillohet në një sipërfaqe prej 14 mijë m<sup>2</sup>, cka do të thotë se gjithë pjesa që kufizohet nga rruga “Heronjtë e Linasit” deri te pjesa mbas shkollës “Muhamet Shehu” duke u bashkuar me bllokun tjetër që është pjesa e stadiumit. Pjesa tjetër që mbetet e bllokut “Naftëtari” do ta kemi në vëmendje në buxhetin tjetër. Njëkohësisht edhe rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” e cila ishte shkolla e vetme në qytet pa u rikonstruktuar edhe pse është shkolla më e vjetër e qytetit. Unë, më duhet të falenderoj të gjithë stafin e asaj shkolle që edhe pse shkolla nuk ka qënë në kushte të kënaqëshme ata e kanë mirëmbajtur. Me rikonstruksionin e shkollës, zhvillohet një sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>, dhe 550 m<sup>2</sup> do të jetë palestra e shkollës, e cila do të jetë me kushte dhe standarde bashkëkohore. Kjo palestër përvecse do t'i shërbejë nxënsve të shkollës “Muhamet Shehu” do të shërbejë edhe si qëndër komunitare ku mund ta përdorin të rinjtë e qytetit. Këto janë dy investime të rëndësishme dhe në këtë moment më lejoni t'i uroj mirëseardhjen Drejtoreshës Rajonale të Arsimit znj.Flutura Mecaj dhe znj.Zamira Velcani, Drejtoreshë e Zyrës Vendore Arsimore Patos. Duke ju falenderuar të gjithëve, më lejoni t'i kaloj fjalën Z.Gerti Shella.



**Minuta: 00:51-07:10 Dokumentimi Audio-Video Link:**

<https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY>

**Konsultoni për më shumë linkun:**

<https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetari-prane-shkolles-muhamet-shehu/>

**Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 3

**Z.Gerti Shella:** Ju faladeroj kryetare, ju përshendes pikë së pari ju, zyrtarët e nderuar të Bashkisë Patos, të gjithë pjesëmarrëit që sot e nderojnë dhe e zbulurojnë këtë dëgjesë në cilësinë e tyre më të mirë. Unë do të them vetëm dy fjalë për modelin që ju me dedikim të përditshëm keni mundur të krijoni. Më shumë sesa sot ne mund të ndihmojmë, jemi këtu për të mësuar që sikurse ju, të gjitha bashkitë e Shqipërisë të munden të zhvillojnë procese të tilla konsultimi, dhe demokracie të drejtpërdrejtë. Ashtu si me të drejtë e tha dhe sekretari i këshillit, është një e drejtë ligjore e qytetarëve për të dhënë mendimin e tyre për projektet e qytetit, pra që janë pronë e tyre dhe do të jenë në shërbim të tyre, mbase është e drejtë edhe e të rinjve duke u mbështetur tek ligji për rininë, në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës dhe të kenë zërin e tyre kur diskutohen projektet për shkollat apo cdo projekt që nxit dhe stimulon programet e zhvillimit rinos. Në këtë kuptim, ne sot jemi këtu që mbi bazën e këtij modeli të mundemi të shkojmë në cdo bashki tjetër dhe ta përhapim si një nga modelet më të mira. Për dijeni të të gjithë pjesëmarrësve, Bashkia Patos është një ndër shtatë bashkitë e perzgjedhura nga UNDP e cila në partneritet edhe me qeverinë shqiptare po mundohen që të risjellin ashtu sic ligji e përcakton të gjithë procesin e konsultimit. Edhe pse kemi 61 bashki, jo cdo bashki mund të sjellë dhe të realizojë këto modele konsultimi publik. Ju faladeroj të gjithëve dhe e nderuar znj.Kryetare uroj që këtë standard ta coni në standart kombëtar.



**Minuta: 07:10-9:24 Dokumentimi Audio-Video Link:**

<https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY>

**Konsultoni për më shumë linkun:**

<https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetari-prane-shkolles-muhamed-shehu/>

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Përpinqemi që të realizojmë punën tonë por sesa e arrijmë jeni dhe te gjithe ju vëzhgues për ta vlerësuar. Fjalën tani më lejoni t'ja kaloj Drejtorit të shërbimeve publike Z.Arben Maroku.

**Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 4

**Drejtori i Shërbimeve publike Z.Arben Maroku:** Përshendetje, do të japim një vështrim të shkurtër të dy projekteve që ne po prezantojmë sot para jush. Projekti i parë është rikonstruksioni i bllokut të lagjes “Naftëtari” pranë shkollës “Muhamet Shehu” dhe vetë Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi palestrës. Punimet për bllokun e lagjes “Naftëtari” përfshijnë:

- Alsfaltimin e rrugës që fillon nga xhamia deri tek stadium “Alush Moka”
- Sistemimi dhe ndërtimi i trotuareve në të dyja anët e rrugës.
- Krijimi i ambjenteve të gjelbërtë ndërmjet pallatave.
- Ndërtimi i kanalizimeve përkatëse për disiplinimin e ujërave të zeza dhe të bardha të kësaj zone.
- Ndërtimi i sipërfaqeve clodhëse për banorët e zonës.
- Mbjelljen e pemëve

Ndërsa përsa i përket punimeve për ndërtimin e shkollës “Muhamet Shehu” përfshijnë:

- Zvëndësimin e të gjitha dyerve dhe dritareve.
- Riparimi i suvatimeve të të gjitha mureve të dëmtuara.
- Krijimi i sistemit të ngrohjes kundër zjarrit dhe rreziqeve të tjera.
- Instalimi i sistemit të ri të ngrohjes.
- Instalime të reja elektrike.
- Rikonceptimi i fasadës së objektit
- Ndërtimi i palestrës së re.
- Riparimi i gjithë territorit të shkollës.

Këto ishin shkurtimisht punimet që do të realizohen në kuadër të këtyre dy projekteve.

 Bashkia Patos, Rikualifikimi i bllokut Naftetari dhe shkolles 'Muhamet Shehu' - pjesa 1	<b>Minuta: 10:17-12:24 Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY</a> <b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamet-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamet-shehu/</a>
---	--

**Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 5

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Z.Arben bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me punimet që do të bëhen për këto dy projekte. Ne i quajmë këto projekte rikualifikime për të sjelle urbanizimin e qytetit dhe dua të theksoj se bashkia po punon fort në lidhje me këtë pikë.

**Drejtoresha Rajonale e Arsimit znj.Flutura Mecaj:** Përshëndetje të gjithëve, faleminderit zonja kryetare që më ke bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Është shumë e rëndësishme që marrim një lajm të mirë që të gjithë e kemi pritur, si kolegët edhe nxënësit. Unë e dëgjova me vëmendje specialistin për të gjitha punimet që do të bëhen në këtë shkollë, patjetër që është një ndërhyrje që do t'i vlejë kolegëve, nxënësve, komunitetit por njëkohësisht do të rritë cilësinë e mësimdhënies. Do të doja që të ecnim paralelisht me rikonstruksionin nga njëra ana por po ashtu edhe me rritjen e cilësisë pedagogjike. Në momentin që bëhen bashkë këto dy elementë gjithëcka realizohet më mirë. Kjo do të jetë një shkollë me ato standarde që nuk i shërbejë vetëm brezave aktuale por edhe brezave që do të vijnë në vijim. Do të doja që ky lajm i mirë të pasohej edhe nga lajme të tjera të mira për shkolla të tjera. Ne do të ndjekim hap pas hapi punimet dhe shpresojmë që vitin e ardhshëm shkollar të fillojmë mësimin në ambjentet e reja të shkollës.



**Minuta: 15:25-17:48 Dokumentimi Audio-Video Link:**

<https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY>

**Konsultoni për më shumë linkun:**

<https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/>

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Faleminderit Drejtoreshë, tani është fjala për qytetarët për të shprehur mendimet e tyre e për t'u bërë pjesë konkretisht e kësaj dëgjese.

Znj.\_\_\_\_\_, Përshëndetje Kryetare, prindër, mësues dhe të gjithë të pranishmit. Faleminderit që na betë pjesë të kësaj dëgjese publike. Është shkolla e fundit në bashkinë Patos për t'u rikonstruktuar dhe mbyllt kështu gjithë blloku i rikonstruktuar i të gjithë objekteve arsimore me një qasje sa më bashkëkohore. Ishte vërtet shkolla e fundit që priti gjithë shkollat e tjera për t'u rikonstruktuar dhe për këtë merion një falenderim të stafit, nxënësve, prindërve për atë shkollë që na ka mikëpritur. Falenderoj dhe prindërit për mirëkuptimin që fëmijët do ta zhvillojnë mësimin

**Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 6

në orarin e pasditess. Kjo shkollë përvec rikonstruksionit të saj ka edhe një dhuratë nga Ministria e Arsimit ku do të instalohen laboratori dentar me fillimin e vitit të ri shkollor. Të gjithë fëmijët do të kenë mundësi të kryen shërbimet falas. Këtë lajm doja ta ndaja me ju. Faleminderit.

 Bashkia Patos, Rikualifikimi i blokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu" - pjesa 1	<b>Minuta:</b> 18:40 <b>Dokumentimi</b> <b>Audio-Video</b> <b>Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY</a> <b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/</a>
--	---

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Ky është një lajm shumë pozitiv por duhet mbajtur shënim sepse duhet të parashikohet vendi se ku mund të bëhet laboratori dentar.

**Shpresa, Banore Lagjia “Naftetari”:** Lagjia jonë mprapa shkollës nëse vjen, nuk ka rrugë. Më përpara ka patur rrugë ku mund të kaloje.

 Bashkia Patos, Rikualifikimi i blokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu" - pjesa 1	<b>Minuta:</b> 21:19 <b>Dokumentimi</b> <b>Audio-Video</b> <b>Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY</a> <b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/</a>
--	---

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Po kush i ka zënë rrugët?


**Shpresa Mahmutaj, Banore Lagjia “Naftetari”:** “I kam zënë unë, tjetri” Vjet kur janë vendosur dritat janë vendosur nga “Elektriku” deri tek “Nishtulla” dhe kur kam kërkuar të vendosen tre drita tek lagjia jonë nuk janë vendosur. Ne kemi të moshuar në shtëpi ata mund të dalin jashtë në mbrëmje por aty mungojnë dritat dhe kjo përbën rrezik.

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Ju dëgjova me shumë kujdes, sot ne jemi mbledhur për të diskutuar për bllokun e lagjes “Naftëtari” dhe rikonstrukzionin e shkollës “Muhamet Shehu” ndërsa për bllokun ku ju jetoni , i cili është blloku më i hershëm i qytetit të Patosit, është menduar të bëhet një studimi se ku kanë qënë rrugicat e asaj lagjes e më pas për t'i rivendosur në vendin e duhur.Për pjesën e ndricimit është parshikuar që këtë vit. Të gjitha blloqet do të rikualifikohen me këto lloj projektesh që po prezantohen sot.

**Donika Bani, Banore Lagjia “Naftëtari”:** Ne sot jemi mbledhur për të diskutuar për bllokun e lagjes “Naftëtari” dhe shkollës, se po të jetë sic thotë znj.Shpresa kërkojmë edhe ne që të bëhet rruga ku kalojnë fëmijët e zonës tonë për të shkuar në shkollë.

 <small>Bashkia Patos, Rikualifikimi i bllokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu"- pjesa 1</small>	<b>Minuta:</b> 25:55 <b>Dokumentimi</b> <b>Audio-Video</b> <b>Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY</a>  <b>Konsultoni</b> <b>për</b> <b>më</b> <b>shumë</b> <b>linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/</a>
--	---

**Përgjegjëse e zyrës Arsimore Vendore znj.Zamira Velcani:** Shumë faleminderit për fjalën dhe po ashtu për realizimin e rrugës në lagjen ku unë banoj, jam shumë e kënaqur dhe e lumtur. Një pyetje kisha për nxënësit, në lidhje transportin sesi do të bëhet i mundur?

 <small>Bashkia Patos, Rikualifikimi i bllokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu"- pjesa 1</small>	<b>Minuta:</b> 27:15 <b>Dokumentimi</b> <b>Audio-Video</b> <b>Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY</a>  <b>Konsultoni</b> <b>për</b> <b>më</b> <b>shumë</b> <b>linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-te-me-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamed-shehu/</a>
--	---

*Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos*

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 8

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Në lidhje me transportin për ta përfituar falas duhet të plotësohen disa kritere; së pari duhet të jesh 2 km larg nga qendra e banimit, dhe nuk duhet të jesh brenda zonës urbane.

**Enkeleda Lipe, Drejtoreshë e shkollës “Muhamet Shehu”:** Ju falenderojmë shumë për këtë takim sot, faleminderit Bashkia Patos dhe Qeveria Shqiptare për realizimin e këtij projekti. Kur po shikonim këtë projekt sot ndihemi shumë të kënaqur dhe të lumturuar. Shkolla jonë ka edhe një pozicion strategjik sepse është përballë stadiumit të qytetit. Shikoj që tek plani janë shtuar hapësirat e gjelbërta gjë që është shumë mirë po ajo që na lumturon më shumë është ndërtimi i palestrës, pasi nxënësit në orën e edukimit fizik do të mund të realizojnë programin mësimor më së miri., por dua të përmend faktin që edhe pse nuk kemi patur palester shkolla jonë është shpallur gjithmonë fituese në kampionatet e zhvillurara mes nxënsve të shkollave të tjera.

 Bashkia Patos, Rikualifikimi i blokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu" pjesa 1	<b>Minuta: 29:28 Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY">https://www.youtube.com/watch?v=SzxhjwIYAVY</a> <b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamet-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamet-shehu/</a>
---	--

**Bajron, Banor tek Banesat Sociale:** Unë kam një problem të madh, por para se t'jua them problemin dua t'ju falenderoj. Problemi është tepër emergjent sepse banesa sociale ku unë banoj nuk ka dritare të mjaftueshme.

 Bashkia Patos- Rikualifikimi i blokut Naftetari dhe shkolles "Muhamet Shehu" pjesa 2	<b>Minuta: 00:49 Dokumentimi Audio-Video Link:</b> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=bKi6LK2BU8o">https://www.youtube.com/watch?v=bKi6LK2BU8o</a> <b>Konsultoni për më shumë linkun:</b> <a href="https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamet-shehu/">https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-rikualifikimi-urban-blloku-i-lagjes-naftetariprane-shkolles-muhamet-shehu/</a>
--	--

*Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos*

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 9

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Do e shikojmë me shumë kujdes këtë cështje dhe do t'i japim zgjidhje.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak Balil Balili:** Së fundmi du atë them se të gjithë duhet të jemi koshientë për investimet që janë bërë në Bashkibë Patos duke nisur nga unaza e Patosit një investim prej 2.3 miliard lekës, rehabilitimi i "29 marsit", i lagjes së re, pallati i kulturës, dhe thënë të gjith akëto te pakten duhet ta kuptojmë sesa ka ndryshuar qyteti por patjetër që ka akoma punë për të bërë.

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** Ne po zhvillojmë gjithashtu dëgjesat për buxhetin dhe aty mund të paraqsnë më mirë se cfarë kemi bërë dhe cfarë do të bëjmë. Për këtë ju ftoj të merrni pjesë në këto dëgjesa dhe më lejoni tani t'ja kaloj fjalën dhe njëherë Z.Gerti Shella.

**Z.Gerti Shella:** Janë disa gjëra që fliten para se të ngurtësohen, këto procese të rëndësishme që nuk janë të lehta për tu zhvilluar pavarësisht se mund të duken të tilla, do ju lutesha qytetarëve, pjesëmarrsve të komunitetit që edhe përmes ndërveprimit me bashkinë të marrin dijeni mbi planin e punës, dhe ta përdorin më së miri të drejtën e tyre. Ju përgëzoj për punën e bërë kryetare shë ju uroj sukses në vijim.

**Kryetarja e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj** mbyll takimin duke shpresuar që gjithëcka do të finalizohet me sukses në të mirë të komunitetit.

**Konceptoi:**

**Koordinatore e Konsultimit Publik**  
Suzana Hysenaj



**Pranoi :**

**Sekretar i Këshillit**  
Balil Balili



---

**Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos**

Email: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al)

Page | 10